

Televizioni dhe ekranizimi i veprës letrare për televizion

*Mimoza Doko **

*Gazmend Abrashi ***

Abstrakt

Televizioni sot është bërë një nga mjetet më të fuqishme të komunikimit masiv, është bërë një nevojë e përditshme e njeriut të shekullit tonë. Ai ndikon në mënyrë direkte në edukimin, formimin etik dhe estetik të njeriut. Si zbulim teknik i shekullit të kaluar mund të renditet ndër më të rëndësishmit.

Avantazhet e televizionit në krahasim me radion dhe gazetën janë se ai ndikon tek shikuesit më fuqishëm për vetë faktin se është një mjet komunikues vizivo-auditiv. Avantazhet e tij në krahasim me filmin dhe teatrin janë se ai në ndryshim nga to i shkon shikuesit në shtëpi dhe si i tillë në kushtet e sotme dhe akoma më tepër në perspektivë, ka një numër shikuesish shumë më tepër se sa kinemaja dhe teatri të marra së bashku.

Në televizion jo çdo gjë që transmetohet ka lidhje me veprën artistike. Lajmet, bisedat shkencore e politike, informacionet, nuk kanë asgjë të përbashkët me artin televiziv.

Fjalë kyç: kinema, ekranizim, vepër letrare, autor, arte televizive.

Ç'kuptojmë me art televiziv dhe a kemi të drejtë ta përdorim këtë?

Dihet se çdo vepër artistike është pasqyrë e shoqërisë në të cilën lind, e rrymave të saj shoqërore, pasioneve të saj, idealeve dhe ndjenjave,

* *Mimoza Doko, PHD Cand. Universiteti AAB, Prishtinë. e-mail:mimoza.doko@aab-edu.net*

** *Gazmend Abrashi, PHD Cand. Prishtinë. e-mail:gazmend.abrashi@aab-edu.net*

por raporti i artit me jetën e shoqërisë përcaktohet nga mënyra e mjeteve shprehëse që përdor ai.

Ndryshe e pasqyron realitetin letërsia, ndryshe teatri, ndryshe filmi.

Po të ndjekim se si e pasqyron realitetin filmi do të kuptojmë se filmi përdor të gjitha artet e tjera nga të cilat rrjedh, i bashkon ato në vetvete dhe njëkohësisht qëndron krahas tyre si art më vete. Disa elemente të letërsisë, teatrit, arteve figurative e muzikës, bëhen pjesë përbërëse të filmit. Këta komponentë shpesh kontradiktorë, nuk janë të vendosur njëri pranë tjetrit, por janë të shkrirë në një sintezë organike për krijimin e një kualiteti të ri artistik, për krijimin e filmit.

Ky është shkaku që filmin e quajnë një art sintetik.

Për krijimin e një vepre kinematografike, marrin pjesë shumë krijues duke filluar nga regjisori, skenaristi, operatori, kompozitori, aktorët etj., duke mos harruar këtu edhe bashkëpunëtorët teknikë dhe ekonomikë. Filmi pra, në ndryshim nga artet e tjera është art kolektiv.

Edhe televizioni përmban në vetvete të gjitha ato mundësi dhe aftësi shprehëse që ka edhe filmi.

Vepra artistike televizive në thelbin e saj, ka elemente të përbashkëta me kinemanë dhe disi më pak dhe me teatrin.

Televizioni është i përafërt me kinematografinë, që në ndryshim nga i pari, bazohet në parimet e fiksimit dhe riprodhimit të realitetit me anën e sistemeve optiko–kimike–kinetike. Televizioni huazon më shumë se çdo art tjetër nga arti kinematografik, e megjithatë televizioni në rrugën e tij po njeh një zhvillim të vrullshëm të mjeteve të tij shprehëse, po kristalizon tipare të tij specifike, po përpiqet të krijojë fytyrën e vet, po formon gradualisht parimet e veta estetike, të cilat duhen njohur dhe përvetësuar në mënyrë që ky art i ri dhe me perspektivë të zhvillohet më tej.

Kinematografia dhe televizioni operojnë me figurën e lëvizshme në ekran të kombinuar me zërin. Dy janë dallimet kryesore në mes tyre: madhësia e ekranit dhe mënyra e perceptimit apo e shikimit. E megjithatë mjaftojnë edhe këto dy karakteristika, për t'i dhënë televizionit të drejtën që të ketë gjuhën e vet.

Edhe për nga struktura e figurës artistike, ata afrohen shumë me njëri tjetrin.

Po kështu, ata nuk janë larg njëri-tjetrit edhe për nga pikëpamja e funksioneve që kryejnë, ndonëse “ekrani i vogël” duke u bërë mysafir i çdo shtëpie, ka një përparësi të pakrahasueshme me atë të sallës. Televizioni lidhet me shumë fije të dukshme e të padukshme edhe me radion, për sa i përket transmetimit, komunikimit.

Atëherë, me të drejtë lind pyetja: Ç’është Televizioni? Mos vallë është një amalgamë e kinematografisë me radion?

Megjithëse ka marrë prej tyre cilësitë më të mira, pikërisht për këtë është më tepër se shumica e këtyre dy pjesëve, pra është njëherazi art dhe gazetari.

Televizioni u jep “pasaportën e qytetarisë”, të gjitha llojeve të krijimtarisë artistike e publicistike.

Fjala “televizion” që do të thotë shikim në largësi, i jep përparësi figurës. Gjuha e tij kryesore, mjeti me të cilin operon është pamja, figura dhe jo fjala, siç është për radion. Këtu qëndron edhe përparësia e madhe e tij në krahasim me llojet e tjera të artit dhe të publicistikës, pra një pamje vlen më shumë se dhjetëra mijëra fjalë.

Teknika e televizionit në çdo hap të saj ka pasur mbështetje shkencat dhe teknologjinë bashkëkohore, duke futur dhe duke zbatuar të rejat që sollën ato në prodhimin dhe perfeksionimin e vazhdueshëm të pajisjeve deri në përdorimin e televizionit me ngjyra.

Televizioni me ngjyra sjell me vete jo vetëm cilësi të reja teknike, por edhe artistike.

Televizioni ka gjuhën e vet, sa më shumë e sa më thellë të njihet ajo si nga realizuesit, ashtu edhe nga teleshikuesit, aq më i madh do të jetë edhe efekti i saj.¹

Çfarë quajmë e çfarë përfshijmë në ekranizimet është një problem estetik, zgjidhja e drejtë e të cilit varet nga përcaktimi bazë i marrëdhënies midis letërsisë dhe kinemasë, si dy arte të veçanta e të pavarura.

“Ekranizimi i një vepre letrare është ajo formë e artit kinematografik, në të cilën autori, duke mos dalë jashtë kornizave të veprës letrare, e rikrijon atë me gjuhën e filmit, me mjetet e veta shprehëse, duke synuar që të japë në ekran sa më thellë e më

¹ Ylli Pepo, *Arti viziv shqiptar*, në *Skena dhe ekрани*, Tiranë, 1987, f. 23.

poetikisht patosin e originalit, thelbin e tij artistik".² Në këtë përkufizim, ekranizimi me të drejtë quhet formë e artit, kinematografik dhe nënvizohen mjetet shprehëse të tij. Po ashtu, me të drejtë kërkohen thelbi dhe fryma e burimit letrar. Në të vërtetë edhe ekranizimi, si formë e një lloji arti të pavarur, ka gjuhën e këtij arti, ai është formë e kinematografisë dhe jo e letërsisë, për rrjedhim, filmi- ekranizim nuk mund të quhet version, qoftë dhe vizual, i veprës letrare.

Përse ekranizojmë?

Përse arti i kinemasë i drejtohet letërsisë? Përse ai ka nevojë për të? Së pari, sepse edhe kinemaja edhe letërsia janë arte dhe, si të tilla, të dyja i nënshtrohen ligjit të përgjithshëm të bashkëveprimit dhe ndikimit të ndërsjellë. Në rrugën e formimit dhe të zhvillimit të vet, kinemaja në veçanti do të merrte nga përvoja shekullore e arteve të tjera, sidomos artit të fjalës.

Së dyti, ekranizimi i risjell spektatorit pasurinë e letërsisë dhe i shumëfishon këtë faktorë të fuqishëm socialë e kulturorë.

Në rastin e ekranizimit, vepra letrare bëhet mjet për të ushqyer e pasuruar kinematografinë me ide, me koncepte artistike, me problematikë jetësore, me subjekte, konflikte e karaktere. Sot ekranizimi është i domosdoshëm, sepse romanet ndihmojnë për të pasuruar përmbajtjen e filmave dhe për të zhvilluar shijet e spektatorit. Ekranizimet sjellin interesa shoqërore të caktuara në çaste historike të caktuara, sepse në veprat letrare zbulojnë ide, mendime e ndjenja që gjejnë jehonë. Aktualiteti i ideve përcakton zgjedhjen e veprës letrare nga kineasti.

Ekranizimi i veprës letrare për televizion nga momenti fillestar e deri në realizimin final, përmban në vetvete shumë faza dhe procese pune, zbatimi i drejtë i të cilave është determinant për realizimin me sukses të veprës.

Ekranizimi i një vepre letrare ose adaptimi i saj nuk është problem i brendshëm i skenarit apo i dramaturgjisë, ai prek të gjithë elementët e krijimtarisë kinematografike dhe televizive.

² Abdurrahim Myftiu: *Nga letërsia te filmi*, Tiranë, 2002, f. 255.

Ekranizimi, huazimi i materialit ose adaptimi, përfaqëson gati gjysmën e prodhimit botëror të kinematografisë dhe televizionit.

Në kritikën e zgjedhjes së veprës letrare për adaptimin e saj për televizion, duhen pasur parasysh veçoritë specifike të televizionit, d.m.th. mundësinë reale të adaptimit të saj për televizion, për krijimin e një kualiteti të ri artistik me mundësitë vizivo-auditive të tij.

Dramaturgu apo regjisori në punën për shkrimin e skenarit letrar duhet të ketë parasysh që t'i përmbahet ideve dhe mendimeve kryesore që përshkojnë veprën letrare duke eliminuar ato momente të parëndësishme që nuk cenojnë tërësinë e veprës. Të nisur nga ky mendim bazë, nuk duhet kaluar në ekstremin tjetër që të ekranizojmë një vepër duke i qëndruar pikë për pikë mendimit të saj, duke u kthyer thjeshtë në ilustrues të veprës. Dramaturgjia dhe regjisori duhet të qëndrojnë mbi veprën dhe ta interpretojnë atë.

Kthimi pra i një veprë letrare nuk është thjeshtë një proces mekanik, qoftë edhe sikur të njihen teknikat dhe specifikat e këtij adaptimi, por kërkon mbi të gjitha njohje të thellë të epokës në të cilën zhvillohen ngjarjet, raportet historike dhe klasore.

Njohja dhe zbërthimi i drejtë i këtyre faktorëve është premisë kryesore për shkrimin me sukses të skenarit letrar.³

Sot ekranizimet e veprave letrare janë ndër gjinitë më të përhapura në botë, por ato kanë filluar relativisht vonë nga transmetimi i veprave të para.

Transmetimet e para televizive të dramave janë kryer në Angli në vitin 1936. Për herë të parë është shfaqur një dramë e Pirandello "Njeriu me lule në gojë".

Aktorët u detyruan të luanin përpara kamerave shumë të rënda në një ndriçim sfilitës dhe me një grim që sot do të ishte qesharak për këdo. Aktorët e studiove të televizionit në atë kohë detyroheshin në kushte shumë më të vështira nga skena dhe xhirimet në filma, t'iu nënshtroheshin provave të shumta në studio jo shumë të përshtatshme. Hundët dhe buzët aktorëve jua lyenin me ngjyrë blu,

³ Viktor Gjika: "Zgjidhja figurative e filmit në funksion të dramaturgjisë" në *Skena dhe ekrani*, Tiranë, 1982, f. 9.

ndërsa faqet me të gjelbër. Kjo bëhej me qëllim që të forcohej kontrasti i figurës.

Më pas televizioni me përmirësimin teknik të transmetimeve solli edhe një përmirësim të ndjeshëm të programeve, krahas filmave dhe spektakleve filluan të transmetohen edhe pjesë të ndryshme të xhiruara drejtpërdrejt nga skena. Këto mund të quhen faza foshnjore dhe hapa fillestarë drejt rrugës së ekranizimeve origjinale.

Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, drama filloi të përpunohej për ekranin e vogël dhe më pas nga mesi i viteve '50 filloi ekranizimi televiziv i gjinive të mëdha letrare, siç janë romani, novela etj.

Suksesi i këtyre ekranizimeve qëndron në atë që adaptimi i shumë serive televizive qëndron më afër veprës në krahasim me variantin kinematografik. Ai tregon aspekte shumë planesh të jetës njerëzore, arrin të ruajë stilin e autorëve dhe të mbërthejë kështu para ekranit të vogël miliona spektatorë përmes serive të ndara ashtu siç janë të ndara në roman, kapitujt.⁴

Filmi artistik televiziv ka ngjashmëritë dhe veçantitë e tij në krahasim me atë kinematografik. Ndodh shpesh që një vepër letrare ekranizohet, pra mbi bazën e veprës letrare ndërtohet një skenar.

Ndërtimi strukturor ndërmjet dy skenarëve të filmit të televizionit dhe atij kinematografik, nuk ka asnjë ndryshim. Ndërsa ndryshimet ndërmjet këtyre dy lloj filmave janë ato që rrjedhin nga specifika e tyre:

Filmi televiziv parapëlqen shkurtimin e planeve dhe skenave masive.

Pëlqen punimin me plane relativisht të afërt.

Pëlqen punimin në mënyrë të veçantë me portretin.

Ndërtimin e interierëve në plane të ngushtë, të përmbledhur.⁵

Kjo vjen nga që filmi televiziv e përqendron vëmendjen më të madhe te dialogu, i cili merr shumë përparësi, pasi dihet që situatat psikologjike janë karakteristike për filmin e televizionit.

Filmi televiziv parapëlqen veprën narrative, ndërsa ai kinematografik jo, pasi i jep më shumë përparësi veprimi.

⁴ Po aty, f. 11.

⁵ Çapajev Gjokutaj: "Regjisori – autor" në *Skena dhe ekrani*, Tiranë, 1988, f. 19.

Të ekranizosh do të thotë në radhë të parë të sigurosh përmbajtjen artistike, pastaj të gjesh ekuivalentin filmik të veprës letrare, ta transplantosh lëndën jetësore të një arti në një art tjetër, por me mjete të tjera artistike.

Krijimi i përfytyrimit, që në thelb përshtatet me atë të veprës letrare, ja ç'është kryesore për ekranizimet. Këtu kemi të bëjmë me dy veçori:

E para, kur filmi ndërtohet mbi një motiv, linjë apo disa të tilla të romanit, tregimit, etj., duke i qëndruar në përgjithësi korrekt ecurisë së tyre dhe, e dyta, kur filmi ndërtohet, si të thuash, nga e para, pra kur ai rindërtohet duke fituar një formë origjinale.

Të dy këto lloj ekranizimesh janë të frytshëm, mjafton të mishërohen qartë e bukur.

Rrugët e ekranizimit të një veprë letrare mbeten tre:

Rruga më e lehtë është ajo e transmetimit të veprës, duke i qëndruar asaj besnike në të gjitha ngjarjet, episodet, personazhet dhe mënyrat shprehëse. Kjo nuk sjell kurrë lindjen e një veprë kinematografike me emocione të reja e më të thella. Filmi në këtë rast shërben vetëm për popullarizimin e veprës letrare. Këtë mund ta bëjë më mirë telefilmi që me kohën e pakufizuar që ka në dispozicion, nuk lë të humbasë asgjë nga vepra letrare.

Rruga e dytë është ajo e transplantimit kinematografik të veprës letrare kur, megjithëse mund të humbasin disa vlera të reja filmike, sepse në saj të kondensimit të ngjarjeve dhe veprimeve, në saj të mishërimit realist dhe të ndërthurjeve dramaturgjike më të plota, ngjarjet bëhen më dramatike, personazhet më të besueshëm dhe emocionet e përftuara janë më të thella. Kjo rrugë është më shpesh në kinematografinë tonë dhe ka dhënë sukseset e njohura.

Rruga e tretë është ajo e shndërrimit të plotë të veprës letrare duke e parë atë me një sy të ri të autorit kinematografik.⁶

Letërsia mund të ushqejë filmin në mënyrë të dyfishtë, nga njëra anë me përvojën e vet artistike, nga ana tjetër me bagazhin konkret të veprave letrare që mund të shërbejnë si burim i drejtpërdrejtë për

⁶ Pirro Milkani: "Aktorë të njohur në plane të panjohur" në *Drita*, Tiranë, 1990, f. 14.

krijimin e veprave kinematografike. Për të përfituar nga ky ushqim kineastët duhet të njohin thellësisht letërsinë dhe autorët e saj, stilin dhe individualitetin e tyre. Vetëm atëherë ata mund të dinë se çfarë duhet studiuar e mësuar tek njëri shkrimtar, e çfarë tek tjetri.

Te Dritëro Agolli do të mësojmë përshkrimin me vërtetësi të ngjarjeve origjinale, nëpër të cilat rrjedh një jetë e gjallë, shpirtin e popullit tonë, krijimin e personazheve të gjalla me karaktere të fortë, satirën e mprehtë etj.

Vepra e D.Agollit i jepet më lehtë ekranizimit, ajo është mjaft vizive, e mbushur me veprime konkrete, situata dramatike e personazhe të prekshëm, të individualizuar.

Tek Ismail Kadare, kineasti mund të mësojë nga dinamika e ngjarjeve, nga origjinaliteti i kapjes së temës, si dhe nga mënyra e konceptimit të së tërës artistike.

Ismail Kadare është shkrimtar i vështirë për ekranin e madh, pasi ai manovron më shumë me figurat letrare se sa me veprimet konkrete dhe i përshtatet mjaft mirë kërkesave të ekranit të vogël.

Për të ekranizuar Kadarenë, duhet kthyer mbrapsht deri te materiali bazë i hollësishëm dhe duhet riorganizuar ai në mënyrë që idetë e rëndësishme të zërthehen në imazhe konkretë, ndërsa figurave të fuqishme letrare t'u gjendet elementi kinematografik.⁷

Nga ana tjetër më shumë se skena, televizioni mund të marrë mbi vete ekranizimin e dramave të repertorit klasik e modern, kombëtar e botëror për dhjetëra e mijëra shikues. Dramat i shkojnë mjaft për shtat ekranit të vogël.

Televizioni po i jep skenës së teatrit një auditor të ri, mijëra herë më të madh nga ç'mund të zërë salla më e madhe, ndaj dhe përpjekjet pozitive bëhen në drejtim të sjelljes në ekran të emocioneve dhe vlerave të plota të veprës.

Një rrugë e ndjekur për transmetimin e dramave në televizion është ekranizimi i tyre, ashtu siç e shikon spektatori në sallë, domethënë pa vënë dorë në to. Ndërsa në disa raste kemi ekranizim të mirëfilltë të tyre duke e shndërruar dramën në një skenar të vërtetë për filmin televiziv. Edhe këtu kemi të njëjtat rrugë e parime që

⁷ Po aty, f. 15.

ndiqen dhe për gjinitë e tjera letrare. Të dy gjinitë janë të afërta shumë me njëra tjetrën, pasi të dyja janë gjini vizive auditive, por çfarë ndryshimi ekziston mes tyre? Për këtë duhet që të dallojmë veçantitë dhe veçoritë e secilës gjini. Ashtu si filmi dhe drama ka zhvillimin e saj dramaturgjik, ka skenën përcaktuese, ka pikën kulmore, ka përfundimin. Ndryshime që e dallojnë atë nga filmi janë se i gjithë konflikti në dramë zhvillohet në një kohë të kufizuar, pra nuk ka shtrirje në kohë dhe hapësirë, zhvillimi i dramës kufizohet në skena dhe mizanskena, të cilat nuk e ndihmojnë dot për vetë specifikën që ka teatri, që të krijojë frymëmarrje.

Në anën interpretuese aktori është i detyruar të interpretojë në mënyrë të tillë që, të ndiqet nga të gjithë spektatorët si nga ata që janë në fillim të sallës, ashtu dhe nga ata në fund të saj. Teatrit i mungon aftësia për të dhënë situata të ndryshme psikologjike të personazheve në atë mundësi që e jep kinematografia, e cila përdor mjetet e saj të thjeshta, por që e kryejnë funksionin e tyre me mjaft efekt.

Filmi seri televizive ka disa mundësi më të mëdha shprehëse se sa filmi kinematografik. Ai të ofron rrugë për të dhënë jetën në tërë epicitetin e saj. Në të ka variacione mjedisesh, karakteresh, ngjarjesh e situatash. I parë në këtë vështrim, filmi seri i afrohet romanit shumë planesh.

Kjo shtrirje e madhe e filmit seri në hapësirë e në kohë, hap disa probleme si për shkrimin e skenarit letrar, ashtu dhe për realizimin e tij. Kryesore mbetet ruajtja e unitetit artistik të veprës. Është e domosdoshme të ruhet me konsekuencë kurbatura dramaturgjike e veprës dhe ajo e rrugës së çdo personazhi. Çdo seri e filmit duhet të qëndrojë si vepër më vete, por dhe e shkrirë në të tërën e tij. Ato duhet të jenë në ngjitje dhe të ruajnë ngarkesën emocionale.

Ekranizimet mund të bëhen edhe me efekt njohës e propagandues për veprat tona letrare, sidomos nga ekrani i vogël, duke i paraqitur ato në gjithë gamën e linjave poliedrike të veprimit e ngjarjeve.

Dhe kemi çfarë të ekranizojmë, që nga romanet, novelat, poemat e njohura, seritë e veprave të zgjedhura, tregimet të cilat janë shumë komodë për ekranin e madh. Pasuria e letërsisë sonë është e madhe, ku filmi ynë ka gjetur, gjen e do të gjejë aty një gurrë të pashtershme motivesh, idesh, subjektsh e vlerash estetike.

Teleshikuesit tanë nëpërmjet ekranit të vogël kanë ndjekur mjaft filma televizivë, prodhime të radiotelevizioneve të ndryshme të botës. Shpejt seria televizive u fut në llojet e pëlqyeshëm të filmit, por mbi këtë filloi spekulimi. Sot për një titull filmi seritë shkojnë me qindra dhe ka edhe ndonjë rast që mund të duket i habitshëm kur numri i tyre arrin me katër shifra. Aktorët e këtyre serive futen të rinj dhe duke vazhduar filmi me vite, ata plaken bashkë me personazhin. Ndikimi i letërsisë ndaj ekranit është pjesë organike e proceseve të natyrshme të zhvillimit historik të artit. Ai u 'ligjëruea' sidomos me afirmimin e skenarit si lloj letrar më vete.

Ashtu si drama dhe komedia në teatër shkruhen për t'u vënë në skenë edhe skenari shkruhet për t'u realizuar në ekran.

Letërsia shqipe, ka një pasuri të pafundme dhe të pashtershme temash e subjektsh që mund të shërbejnë për ekranizime të arrira dhe me nivel. Ajo është një bazë e mirë për këtë, një burim me 'prurje' të madhe që le ta pohojmë, he për he nuk është shfrytëzuar sa dhe si duhet nga kineastët tanë, e aq më shumë nga krijuesit dhe realizuesit e filmit televiziv shqiptar.

Veprat tona letrare të të gjitha gjinive janë dhe mbeten një nga rrugët më efikase për pasurimin tematik e problematik të filmit tonë.

Niveli i arrirë artistik i letërsisë prin dhe në nivele të arrira në fusha të tjera të artit, duke futur këtu veçanërisht kinematografinë dhe televizionin.

Cilësia e lartë arrihet nga krijues që kanë interesa të shumanshme, që kanë pasione të mëdha. Në çdo vepër ajo që duhet të duket e shprehet qartë, është mendimi dhe mesazhi filozofik. Pa këtë, veprat bëhen të rëndomta, pa këtë, asnjë formë e asnjë stil nuk i shpëton dot.

Me guxim, me fantazi krijuese e kompetencë profesionale, kineastët t'u drejtohen burimeve letrare, por kjo nuk mund të arrihet pa i njohur mirë ato, pa u zhytur në thellësi të traditës sonë më të mirë, në krijimtarinë e mjeshtërive tanë të mëdhenj të penës: N.Frashëri, Çajupi, Migjeni, Noli, Kadare, Agolli etj.

Në gjerësinë e vet me përmasat e vërteta që ka jeta dhe që jepen në veprën letrare, mund dhe duhet të operojë filmi serial televiziv.

Ekranizimi i romanit është një nga bazat më të mira për të, ku krijuesit tanë duhet të drejtojnë vëmendjen nga kjo gjini letrare, e cila akoma nuk ka vendin e duhur në ekranet tona.

Realizuesit e filmit seri televizive, mund të luftojnë për gjetje dhe forma sa më të larmishme, të cilat shpesh burojnë nga këto vepra letrare.

Pasuria e madhe tematike e letërsisë sonë lejon që krahas filmit me skenar original të zhvillohen më tej ekranizime, një fushë kjo me tepër interes për televizionin.

Teleshikuesit tanë që janë njëkohësisht dhe lexues konsumatorë të veprave letrare do të gjenin kështu në ekranin e vogël të shtëpisë ato personazhe të dashur që i kanë hasur në faqet e librave, ato ngjarje të mëdha të historisë së kombit, të cilat pena e shkrimtarëve tanë i ka sjellë të gjalla në letërsi. Kështu të gjalla do t'i sillte këto si dhe vlerat e tjera të letërsisë sonë interpretimi sa më i ngrohtë përpara kamerës që tashmë ka fituar një lloj eksperience komunikimi 'televiziv' me teleshikuesin.

Nga kjo rezulton se televizioni ka mundësi të pakufizuara që në të ardhmen të perfeksionojë edhe më shumë aftësitë dhe mjetet e tij shprehëse.

Nuk duhet injoruar fakti se vepra artistike televizive ndiqet në shtëpi nga një rreth i kufizuar njerëzish, të cilët nuk e kanë atë përgatitje shpirtërore që ka shikuesi i kinemasë apo i teatrit për të ndjekur veprën artistike. Kjo gjë duhet t'i imponohet atij vetëm në rast se do t'i servojmë një vepër me nivel të lartë artistik dhe me një interpretim që t'i përgjigjet specifikës së ekranit.

Duke pasur parasysh se madhësia e ekranit të televizorit është më e vogël se ajo e kinemasë, do të ishte me vend përdorimi më i shpeshtë i planeve bust dhe detaje, por në këtë rast në asnjë mënyrë nuk duhet të harrojmë ligjshmërinë e montazhit dhe të kalojmë në ekstrem duke përdorur vetëm planet detaje se kështu do të humbiste logjika e tregimit të ngjarjes..

Televizioni tek ne lindi dhe po zhvillohet me vrull. Arritjet e deritanishme janë optimiste, por ka akoma tepër për të bërë.

Në mbyllje mund të themi se filmi artistik në përgjithësi dhe ai televiziv në veçanti ka bërë hapa përpara nga pikëpamja e zgjidhjeve

figurative, si falë lirisë krijuese më të madhe se më parë, ashtu edhe falë bashkëpunimit me prodhuesin e huaj me aftësi teknike e teknologji më të larta.

Kryesorja është që filmi shqiptar nuk vdiq. Kinemaja shqiptare vazhdon të ketë krijuesit e vet, të krijojë sistemin e vet të plotë që elementet përbërëse të domosdoshme për të qenë 'sistem' të mos mbesin në letër, por të bëhen realitet në numër filmash, në shumëllojshmëri zhanresh e stilesh, e në radhë të parë, në vlera e tipare kombëtare, për të qenë të plotvlershëm, si brenda vendit, ashtu edhe në integrimin me kulturën evropiane e botërore.

Bibliografia

Pepo, Ylli. "Arti viziv shqiptar". *Skena dhe ekrani*, Tiranë: 1987.

Myftiu, Abdurrahim. *Nga letërsia te filmi*, Tiranë: 2002.

Gjika, Viktor. "Zgjidhja figurative e filmit në funksion të dramaturgjisë". *Skena dhe ekrani*. Tiranë: 1982.

Gjokutaj, Çapajev. "Regjisori – autor". *Skena dhe ekrani*. Tiranë: 1988:

Milkani, Pirro. "Aktorë të njohur në plane të panjohur", në *Drita*, Tiranë: 1990.